

**LIGJ**  
**Nr. 33/2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE  
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

*(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.2.2026)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI**

Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

**Neni 1**

*(Shfuqizuar fjalia e parë e shkronjës “a” me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.2.2026)*

Shkronja “a” e pikës 5 të nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“a) Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

**Neni 2**

**Dispozitë tranzitore**

*(Shfuqizuar pika 2 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 17.2.2026)*

1. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet për herë të parë nga Këshilli i Ministrave jo më herët se data 1.1.2026.

2. Shfuqizuar.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 25.5.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 73, datë 29.5.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**